

LIGJ
Nr. 29/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ MALIT TË ZI**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Malit të Zi.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.3.2012

Shpallur me dekretin nr. 7374, datë 9.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË MALIT TË ZI MBI SHLYERJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NDAJ MALIT TË ZI

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi, më poshtë të quajtura “Palët”,

me qëllim që:

- të zhvillojnë bashkëpunim afatgjatë dhe të qëndrueshëm tregtar, ekonomik dhe financiar bazuar në parimet e përfitimeve të përbashkëta;
 - të finalizojnë shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Malit të Zi; dhe
 - në pajtim me memorandumin ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Republikës së Serbisë, Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me shlyerjen e shumave në llogaritë sipas shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të nënshkruar më 14 dhjetor 2010 në Tiranë, Shqipëri,
- kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët konfirmojnë që:

1. Gjendja përfundimtare për shlyerje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi, duke

përfshirë interesin e rregullt të llogaritur për periudhën nga data 31 mars 2006 deri më 30 shtator 2009, përllogaritet 532,823.61 (me fjalë: pesëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e tre dhe 61/100 dollarë kleringu).

2. Shuma e parashikuar në pikën 1 të këtij neni përbën borxhin e Republikës së Shqipërisë kundrejt Malit të Zi në dollarë kleringu që nga data 30 shtator 2009.

3. Palët bien dakord që borxhi i llogaritur në dollarë kliringu, sipas parashikimit të nenit 1.2, konvertohet në borxhin e llogaritur në dollarë amerikanë (USD), duke zbatuar kursin e këmbimit prej një dollar kleringu = 1 dollar amerikan.

4. Palët bien dakord që pas konvertimit të përmendur në nenin 1.3, borxhi i Republikës së Shqipërisë ndaj Malit të Zi, që nga data 30 shtator 2009 përllogaritet 532,823.61 (me fjalë: pesëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e tre dhe 61/100 dollarë amerikanë).

Neni 2

Palët bien dakord për kushtet e mëposhtme, për shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Malit të Zi:

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë paguan interes për shumën e borxhit në pajtim me neni 1 të kësaj marrëveshjeje, me normën libor USD 6-mujore për periudhën që fillon më 1 tetor 2009 deri në shlyerjen përfundimtare të borxhit.

2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë transferon në llogarinë e përcaktuar nga Ministria e Financave të Malit të Zi, shumën e plotë të borxhit, në mënyrën e mëposhtme:

a) Dy pagesa gjysmëvjetore të barabarta të shumës principale, plus interesin më 31 janar dhe 31 korrik të çdo viti, që këtu përcaktohen si data të pagesës;

b) Data e parë e pagesës së shumës principale dhe interesit është në datën që vjen menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje;

c) Interesi llogaritet bazuar në numrin faktik të ditëve të kaluara dhe një viti me 360 ditë;

d) Norma e zbatueshme e interesit është libor USD 6-mujore më 31 janar dhe 31 korrik të çdo viti. Nëse data 31 janar ose 31 korrik bie ditë pushimi në një prej vendeve, norma e zbatueshme libor USD 6-mujore është ajo e ditës pararendëse të punës.

Interesi i zbatuar për pagesat e vonuara të shumës principale dhe interesit llogaritet me normën libor USD 6-mujore plus 2% në vit.

3. Ministria e Financave e Malit të Zi është e detyruar t'i dërgojë një njoftim me shkrim Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, 15 ditë para datave të pagesës. Njoftimi do të përfshijë shumën e principalit dhe interesit të llogaritur, si dhe udhëzimet për pagesën.

Neni 3

Palët bien dakord të zgjidhin çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga kjo marrëveshje me pajtim. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me pajtim, Palët bien dakord që mosmarrëveshja të zgjidhet përfundimisht në pajtim me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

Vendimi i arbitrazhit është përfundimtar, detyrues për të dyja Palët dhe i zbatueshëm brenda afatit të specifikuar në vendim.

Palët bien dakord që arbitrazhi të zhvillohet në pajtim me procedurën e përcaktuar nga rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris. Ligji i zbatueshëm është ligji lëndor francez.

Gjuha e arbitrazhit është gjuha angleze.

Neni 4

Kjo marrëveshje ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim të të dyja Palëve.

Neni 5

Njoftimet e bëra në pajtim me këtë marrëveshje drejtohen si më poshtë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit Publik
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: ++3554228405
Faks: ++3554228494

Për Qeverinë e Malit të Zi
Ministria e Financave
Stanka Dragojevica No. 2, Potgorica, Montenegro
Tel.: ++38220202167
Faks: ++38220241141

Neni 6

Kjo marrëveshje aprovohet në pajtim me ligjet e secilës Palë dhe konfirmohet nëpërmjet shkëmbimit të njoftimeve. Ajo hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit.

Marrëveshja mbetet në fuqi deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të të dyja Palëve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Bërë në....., më.....2011, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës
së Shqipërisë
Ministri i Financave

Në emër të Qeverisë së Malit të Zi
Milorad Katnic, Ph.D
Ministër Financave